



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:117655

Datë: 14.12.2023

Numri i dokumentit: 05065993

C.nr. 296/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala - në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.A, nga Prishtina, dhe A.K.E.A.O.J.Q.A, nga Prishtina, të cilët i përfaqëson avokat A.J, nga Prishtina sipas autorizimit, kundër të paditurit K.K, Komuna Pejë, baza juridike kompensim i dëmit jomaterial për shkak të shpifjes dhe fyerjes, në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe të paditurit, pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 24.11.2023, ndërsa me datë 13.12.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesë padia e paditësve S.A, nga Prishtina, dhe A.K.E.A.O.J.Q.A, nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri K.K nga Komuna Pejë, që të përmbahet nga shpërndarja dhe ta tërheq nga tregu i shitjes librin me titull “.....” botimi i vitit 2018, në Tiranë si dhe të gjitha ribotimet eventuale të tij, si dhe t’i largojë nga përmbajtja e librit në faqet 71-73, të gjitha informatat shpifëse dhe fyese ndaj reputacionit të paditësve. Të detyrohet i padituri që ta ndal shpifjen dhe fyerjen ndaj paditësve dhe të pretoj se nuk do të përsëritet më në të ardhmen. Të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit jo material për dëmtim të reputacionit, të shkaktuar me përgatitjen, botimin, shpërndarjen dhe plasimin në tregun e shitjes të librit me përmbajtje shpifëse dhe fyese me titull “.....” botim i vitit 2018 në Tiranë, si dhe dëmit të ardhshëm, paditësit të parë t’ia paguajë shumën prej 150,000.00 euro (njëqindpesëdhjetë mijë) euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit jo material për dëmtim të reputacionit, të shkaktuar me përgatitjen, botimin, shpërndarjen dhe plasimin në tregun e shitjes të librit me përmbajtje shpifëse dhe fyese me titull “.....” botim i vitit 2018 në Tiranë, si dhe dëmit të ardhshëm, paditësit të dytë t’ia paguajë shumën prej 100,000.00 euro (njëqindmijë) euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, pranë kësaj gjykate me datë 22.03.2018, kanë parashtruar padi kundër të paditurit, të njëjtën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 20.09.2023, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET i padituri K.K, nga Komuna Pejë, që të përmbahet nga shpërndarja dhe ta tërheq nga tregu i shitjes librin me titull “.....” botimi i vitit 2018, në Tiranë si dhe të gjitha ribotimet eventuale të tij, si dhe t’i largojë nga përmbajtja e librit në faqet 71-73, të gjitha informatat shpifëse dhe fyese ndaj reputacionit të paditësve. Të detyrohet i padituri që ta ndal shpifjen dhe fyerjen ndaj paditësve dhe të premtoj se ko nuk do të përsëritet më në të ardhmen. Të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit jo material për dëmtim të reputacionit, të shkaktuar me përgatitjen, botimin, shpërndarjen dhe plasimin në tregun e shitjes të librit me përmbajtje shpifëse dhe fyese me titull “.....” botim i vitit 2018 në Tiranë, si dhe dëmit të ardhshëm, paditësit të parë t’ia paguajë shumën prej 150,000.00 euro (njëqindpesëdhjetë mijë) euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit jo material për dëmtim të reputacionit, të shkaktuar me përgatitjen, botimin, shpërndarjen dhe plasimin në tregun e shitjes të librit me përmbajtje shpifëse dhe fyese me titull “.....” botim i vitit 2018 në Tiranë, si dhe dëmit të ardhshëm, paditësit të dytë t’ia paguajë shumën prej 100,000.00 euro (njëqindmijë) euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit të saj të deponuar në këtë gjykatë si dhe të gjitha thëniet nga shqyrtimi kryesor, në tërësi është vërtetuar e drejta subjektive e paditësve nga e cila është me së e qartë dhe përtej çdo mëdyshje se i padituri si autor i librit “.....”, viti 2018, në f. 71, 72, dhe 73, ka plasuar informata të pasakta me përmbajtje të rëndë degraduese, shpifëse dhe fyese dhe i kërkojmë edhe shpenzimet e procedurës civile dhe gjykatës i dorëzojmë në formë të shkruar në dy ekzemplare fjalën përfundimtare.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi: mbesim pranë kundërshtimit të padisë dhe e kërkesëpadisë të paditësve, për faktin se nga provat e seancave të mëparshëm dhe dëshminë e paditësit S.A të dhënë në cilësi të dëshmitarit me dt. 29.10.2023 është vërtetuar fakti se padia dhe kërkesëpadia e tyre është bërë me keqbesim dhe si të tilla nuk janë të bazuara në asnjë provë materiale. Padia e paditësve jo vetëm që është në kundërshtim me vetveten po ajo si e tillë është stilizuar dhe hartuar kinse duke u bazuar në disa raste analoge të gjykuar nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut dhe asnjë nga rastet e përshkruara në padi nuk është e përafërt me çështjen konkrete, kështu çështja Faifer kundër Austrisë ka të bëjë me publikimin e një studiuesi austriak i cili i kishte minimizuar dhe arsyetuar krimet e Hitlerit me kinse shpalljen e luftës së hebrenjve kundër Gjermanisë, kjo e pavërtetë nuk ishte dëgjuar kurrë më parë dhe në rastin konkret nuk ishte dëgjuar një e pavërtetë e panjohur po janë publikuar të dhënat e publikuara dhe ri publikuara nga të gjitha mediat vendore dhe dhjetëra reportazhe dhe artikuj të institucioneve vendore kredibile dhe ndërkombëtare të cilat paditësit asnjëherë deri më tani me asnjë formë nuk e kanë kundërshtuar vërtetësinë e tyre, gjithashtu edhe çështja Krakao kundër Hungarisë dhe çështja Bladet Tomson kundër Norvegjisë janë çështje krejtësisht të trilluara në kontest të rastit konkret, ku më gjërësisht

i dorëzojmë gjykatës fjalën përfundimtare në formë të shkruar, vetëm dua të potencoj se libri im është i bazuar dhe çdo shkronje e librit tim është e cituar në 42 publikime të autorizuara kredibile, legjitime me autor të njohur me recensentë legjitim dhe të cilat nuk janë kontestuar asnjëherë nga paditësit. Pretendimet e paditësit se librin tim është dashur të përdoret fjala pezullim i përkohshëm e jo ndalim dhe në bazë të tyre është dashur të shkruhet edhe vendimi i MAP për pezullim shumë vjeçar kundër kushtetues të A. nuk kanë relevancë akademike në të gjitha terminologjitë gjuhësore fjala ndalim e ka ndalimin e përkohshëm, porosi apo urdhër të mos bëhet diçka etj., gjithashtu edhe pretendimet e paditësve se sikur ato që janë shkruar në librin tim dhe mediumet e ndryshme vendore edhe ndërkombëtarë po të ishin të vërteta do të ishin dënuar nga gjykatat ngase nuk qëndrojnë këto pretendime ngase mos ndëshkueshmëria e një personi nuk nënkupton edhe pastërtinë e tij juridike. Libri im është një vepër origjinale e shkruar me kujdes dhe përgjegjësi morale dhe akademike sipas ligjit për të drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe sipas të gjitha ligjeve të tjera të zbatueshme në RKS, duke i respektuar me përpikëri edhe kriteret e përcaktuara me Konventën Universale të Parisit për të drejtën e autorit. Ai i tillë ky libër ishte një publikim tejet i arsyeshme dhe i domosdoshëm ngase kishte për qëllim sensibilizimin e opinionit vendor dhe atij miqësor ndërkombëtar që manifestonte ekstremizmin për vlerat kombëtare, interesin shtetëror, mirëqenien e popullatës dhe sigurinë tonë kombëtarë.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: 4 faqe te librit “.....”, aktgjykimi A.nr. 2345/2014 i dt. 09.11.2017, vendimi nr. Ref: 06/270/2014 i dt. 17.09.2014, vendimi nr. 02/2014 i dt. 23.10.2018, vendimi me nr. 06/342/2015 i dt. 23.10.2015, vendimi nr. KSHA-OJQ/05-2015 i dt. 16.12.2015, vendimi ref: 06/470-3/2016, pasqyra e përgjithshme e aktiviteteve të O. A. reportazhi (u shënuar 22 maji dita ndërkombëtare e Biodiversitetit), reportazhi (në Podujeve u shënuar dita botërore e ujit), reportazhi (u shënuar dita botërore e mjedisit), reportazhi (dita ndërkombëtare e planetit po shënohet edhe në komunën Podujevës), reportazhi u shënuar dita botërore e planetit), reportazhi (A. shënon 30 gushtin), reportazhi (aktiviteti tradicional dhurata e Bajramit), reportazhi (hapet ekspozita me artizanale turke), reportazhi (radikalizmi i Islamit rrezik apo fobi pjesa IV), reportazhi nga Gazeta Express (Pushteti turk arrestoj edhe Uslu (gazetari që tregoj për lidhjen e Turqisë me radikalizmin islamik në Kosovë), reportazhi (Qeveria turke po e financon radikalizmin Islam në Kosovë), reportazhi nga Gazeta PORT, reportazhi nga Today's Zaman, artikulli nga Gazeta Express (Historia e radikaleve në Kosovë që ngatërron tre shtete), artikulli nga lajmi.net, (mbyllet AKEA organizatë e lidhur me vëllazërinë myslimane), artikulli nga Radio Evropa e lire (OJQ-të që promovuan ekstremizmin nuk u lejohet veprimtaria), artikulli në gazetën tema (Mbyllet A. O. e imanit të bikut e lidhur me vëllazërinë myslimane), artikulli në portalin Telegrafi, (mbyllet O. e imanit që është e lidhur me vëllazërinë myslimane), artikulli nga Today's Zaman, (cila është lidhja midis T., Grupeve radikale dhe A.), artikulli nga Gazeta Express, e dt. 30.01.2015, si dhe dëgjimin e paditësit S.A, në cilësi të palës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala e padituri kishte bërë publikimin e librit “.....”.

Kontestuese në këtë çështje ishte baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht nëse publikimi në libër nga i padituri kishte përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj paditësve, gjë që do të ishte bazë për kompensim dëmi.

Nga provat e administruara gjykata gjeti se i padituri në vitin 2018 kishte publikuar librit “.....”, dhe pala paditëse pretendon se në librin e lartcekur i padituri gjatë përpilimit të këtij libri pikërisht nga faqja 71-73 kishte shpifur dhe fyer në raport me paditësit, në shtatë informacione të cekura në këtë libër: 1) “udhëheqës i kësaj organizate (fjala është për A.) ku S. A imam në xhaminë 4 Ll. në Prishtinë ka studiuar fenë islame në Riad te Arabisë Saudite. Në opinion ai vlerësohet si njeri ndër anëtarët e profilit të lartë të vëllazërisë myslimane (MB) që bashkëpunon ngushtë me fondacionin IHH dhe strukturat udhëheqëse të partis AKP (Adelt Ve Kaklinma Partisi) e presidentit turk Rexhep Taip Erdogan “ 2-3) “ sipas shume vlerësimeve A. ka vepruar në Kosovë si degë e Agjencisë Shtetërore Turke për bashkëpunim dhe zhvillim-TIKA dhe njëkohësisht ka marrë donacione nga Organizatat Saudite që e mbështetësin terrorizimin” 4) “çdo anëtar i kësaj organizate ka pasur për detyrë të identifikojë se paku tre kandidatë të mundshëm për rekrutim në organizatë dhe pas testimit të besnikërisë dhe lojalitetit është bërë pranimi i tyre ceremonial në organizatë, kjo ceremoni quhet “Takimi i ngritjes” dhe fillon në dhomë të errët në mbrëmje dhe zgjat deri në faljen e namazit të sabahut “ 5) “kështu AKEA përmes një veprimtarie konspirative dhe masivizimit të saj, kishte planifikuar marrjen e pushtetit në Kosovë” 6-7)” Më dt. 17.09.2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë vendim për ndalimin e aktivitetit të A. dhe 16 organizatave të tjera në Kosovë për shkak të zhvillimit të veprimtarisë antikushtetuese, përhapjes së ideologjisë ekstreme, nxitjes së urrejtjes ndër fetare dhe rekrutimit të vullnetarëve kosovare për formacionet e ndryshme të armatosura dhe grupet terroriste në Siri dhe Irak”.

Duke qenë se padia e paditësve ka të bëjë me kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të fyerjes, gjykata gjeti se, në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65), si ligj i veçantë, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil.

Me nenin 1 paragraf 1, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji nr. 02/L-65), përcaktohet se: “ Ky Ligj ka për qëllim të rregulloj përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke siguruar: a) Të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 të dt. 15 Maj 2001) dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore në Njeriut, ndërsa në pikën b), të po këtij neni, përcaktohet se: “ Rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen të mos vënë kufij të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun”.

Me Nenin 3 pika b) të kësaj dispozite përcaktohet se: Fyerja nënkupton deklarin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”

Lidhur me përgjegjësinë për fyerje Ligji në nenin 5 par.1 ka paraparë se: “Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj”.

Gjykata në seancën e datës 19.10.2023 ka bërë dëgjimin e paditësit S.A ku i njëjti kishte deklaruar se me librin kam rënë në kontakt pasi që është promovuar në Tiranë nga autori dhe miqtë e tij, ajo që ka qenë shokuese për mua dhe organizatën tonë. Është se jemi akuzuar për gjëra të cilat që nga pas lufta e gjerë më tani i kemi luftuar me idetë, projektet dhe aktivitetet tona, për këtë mund të ju sjellim qindra aktivitete dhe projekte, dhe prononcime dhe ligjërata personale të miat në të cilat e kemi dëshmuar luftimin e ideve ekstreme, kemi luftuar propagandën që është bërë për ekstremizmin e rinisë së Kosovës, kemi organizuar seminare, tribuna dhe simpoziume ku kemi shfaqur haptazi, jo vetëm mos pajtimin tonë, por edhe mos pajtimin e islamit tonë të bukur, fesë tonë të bukur me ekstremizmin dhe terrorizimin për çka, Z. K.K na akuzon edhe personalisht edhe si organizatë. Do të cekja që deri në ditën e sotme pothuajse 20 vite pas lufte unë si individ por edhe kryesisë së organizatës A. nuk kemi marrë ftesë qoftë edhe njëherë prej organeve të sigurisë dhe të hetuesisë dhe gjyqësisë të Kosovës, që flet mjaftë për atë se kush kemi qenë dhe çfarë kemi punuar, kemi marrë edhe dekorata-mirënjohje nga ministritë e ndryshme dhe komunat e ndryshme për aktivitetet tona. Dhe kemi pranuar financime nga ministritë dhe komunat.

Paditësi deklaron padyshim se publikimet e ndryshme në portale e se fundmi botimi i librit përplotë shpifje dhe akuza të pabaza, ka ndikuar tek njerëzit dhe institucionet që vërtetë të kenë rezerva ndaj organizatës sonë, ne kemi vazhdua me qenë të pezulluar si organizatë e cila e ka hedhur në gjyq Ministrinë e Administratës Publike e cila e ka pezulluar fushë veprimtarinë tonë, me të cilën vazhdojmë sot e tutje duke hyrë dhe dalur nëpër gjykata, po falë zotit dhe ligjeve të shtetit tonë, neve nga janari 2020 jemi kthyer punës së plotë dhe A. vepron lirshëm me të gjitha kapacitetet e veta. Për çdo punë që kemi bërë ne mburremi për atdhe. Këto shpifje dhe akuza janë krejt të baza me konkret gazetën Express kemi biseduar me L.K- Kryeredaktor të cilit ia kemi shprehur shqetësimin tonë dhe mospajtimin tonë, për gjithë ato shpifje dhe akuza, të cilat nuk i ka dëshmuar shteti por edhe për të cilat qoftë edhe një herë nuk jemi kontaktuar nga këto portale që së paku të merret mendimi ynë, për atë që supozon apo pretendon një portal ose gazetar i caktuar, edhe pse zyrat tona janë të mirënjohura dhe adresa jonë në Prishtinë, pos kësaj do të cekja se Z. K ceku se në portale ndërkombëtare kanë shkruar për ne se e ka fjalën për Today Zaman e Turkisë edhe një portal i tyre që nuk me kujtohet emri me këtë rast ju njoftojë se i kam paditur ata në Stamboll të Turkisë, dhe e kam fituar rastin dhe gjykata i ka obliguar ata postier ti largojnë ato shkrime të pabaza. Po te qëndronin shpifjet e Z.K shteti do të duhej të vepronte. Kemi demantuar por duke pas parasysh se shkrimet ditore të mediave dhe portaleve të ndryshme janë aq të shumta dhe të pabazuara ka qenë e pamundur të mirremi me to, por kur e pamë se edhe fusha shkencore e cila duhet të flet në gjuhën e argumenteve dhe fakteve e që

është libri ne nuk kemi mund te heshtim dhe prandaj edhe e kemi paditur autorin, dhe presim fakte nga ato qe ka shkruar, e qe ky shtet nuk i paska ditur për të gjitha këto vite. Gjithashtu i njëjti kishte deklaruar se kur për asnjë ditë të vetme nuk ka qenë e mbyllur A., por nga shtatori 2014, deri në vitin 2019, aktiviteti i saj ka qenë i pezulluar, nga Ministria e Administratës publike, por zyret i kemi pasur të hapura dhe asnjëherë nuk jemi vizituar nga organet e sigurisë. arsyeja pse është pezulluar e jo ndaluar veprimtaria e A., shteti ynë e ka dhënë përgjigjen me lejmin e veprimtarisë se A. nga janari 2020.

Nga provat e administruara nuk u vërtetua fakti se i padituri në librin e tij në faqet 71-73 i cili është objekt i këtij kontesti ka shpifur ndaj paditësve, pasi që në rastin e parë ku pretendohet se është bërë shpifja me fjalët “udhëheqës i kësaj organizate (fjala është për A.) ku S.A imam në xhaminë 4 Ll. në Prishtinë ka studiuar fenë islame në Riad të Arabisë Saudite. Në opinion ai vlerësohet si njeri ndër anëtarët e profilit të lartë të vëllazërisë myslimane (MB) që bashkëpunon ngushtë me fondacionin IHH dhe strukturat udhëheqëse të partisë AKP (Adelt Ve Kaklinma Partisi) e presidentit turk Rexhep Taip Erdogan” lidhur me këtë pretendim të palës paditëse se i padituri ka shpifur në këtë paragraf të librit të tij, pala e paditur ka bashkangjitur prova se lidhur me këtë informacion i njëjti e ka marrë nga mediat ku në shkresa të lëndës ka bashkangjitur si prova botimet nga KOHA me titullin “Qeveria Turke financon radikalizmin islam në Kosovë” gjithashtu artikujt me të njëjtin titull të publikuar nga portali Telegrafi dhe raliteti.info, ku theksohet e njëjta përmbajtje siç i është referuar i padituri në librin e tij. Gjithashtu i njëjti në librin e tij ka treguar se si burim duke e vendosur me fusnotë artikullin në të cilin i njëjti është bazuar Tudays Zaman, e gjithashtu artikullin e ka dorëzuar si provë.

Ndërsa për shpifjen 2-3) të pretenduar nga paditësi ku i padituri në librin e tij ka shkruar se “ sipas shumë vlerësimeve A. ka vepruar në Kosove si degë e Agjencisë Shtetërore Turke për bashkëpunim dhe zhvillim-TIKA dhe njëkohësisht ka marrë donacione nga Organizatat Saudite që e mbështetësin terrorizimin” përsëri në këtë formulim i padituri e ka mbështetur në publikimin e gazetës turke Tudays Zaman duke e cituar në fusnotë edhe publikimin se nga ku i njëjti i ka marr këto informata.

Gjithashtu shpifja tjetër e 4) e pretenduar nga palët paditëse ku i padituri ka shkruar se “çdo anëtar i kësaj organizate ka pasur për detyrë të identifikojë se paku tre kandidatë të mundshëm për rekrutim në organizatë dhe pas testim të besnikërisë dhe lojalitetit është bërë pranimi i tyre ceremonial në organizate, kjo ceremoni quhet “Takimi i ngritjes” dhe fillon në dhomë të errët në mbrëmje dhe zgjat deri në faljen e namazit të sabahut “ dhe shpifja e 5) e pretenduar “kështu A. përmes një veprimtarie konspirative dhe masivizimit të saj, kishte planifikuar marrjen e pushtetit në Kosovë “ gjithashtu këto deklarata i njëjti e ka cituar nga publikimi i Organizatës Ç. me titullin “Radikalizmi i Islamit Rrezik apo Fobi. Pjesa IV-të” gjithashtu i njëjti pas shkrimit të tij në librin e kontestuar e ka cituar burimin se ku i ka bazuar këto të dhëna duke i vendosur edhe fusnotë me linkun e artikullit të publikuar.

Shpifja 6-7) e pretenduar ” Më dt. 17.09.2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë vendim për ndalimin e aktivitetit të A. dhe 16 organizatave të tjera në Kosovë për shkak të zhvillimit të veprimtarisë antikushtetuese, përhapjes së ideologjisë ekstreme, nxitjes së

urrejtjes ndër fetare dhe rekrutimit të vullnetarëve kosovare për formacionet e ndryshme të armatosura dhe grupet terroriste në Siri dhe Irak” gjithashtu edhe në këtë rast i padituri këtë shkrim e ka bazuar në një publikim Emre Uslu në gazetën Tудay Zaman.

Andaj duke u bazuar në nenin 6 par. 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65), i cili parasheh se “Në të gjitha veprat për shpifje dhe fyerje, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik, i padituri do të ketë barrën e provave për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij dhe konstatimi nga gjykata se një nga deklaratat e fakteve që vihen në dyshim është në thelb e vërtetë e përjashton të paditurin nga çdo përgjegjësi” pra pala e padituri për çdo shpifje të pretenduar nga paditësit ka dorëzuar artikuj dhe publikime nga mediat vendore siç janë Lajmi.net “mbyllet A. organizata e lidhur me Vëllazërinë Myslimane” shkrime nga Koha, Telegrafi, Express, Tудay Zaman, hulumtimin e Organizatës Ç. etj., pra të gjitha shprehjet nga faqja 71-73 ku pretendohen se janë shpifje nga i padituri në raport me paditësit, i njëjti i ka përdorur dhe përshkruar nga publikimet e medimeve.

Pra për tu konsideruar si shpifje dhe fyerje një deklaratë duhen të plotësohen kushtet të cilat përcaktohen me nenin 3 pika a) dhe b) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65), përcakton se a) “Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër. b) Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese” e në rastin konkret me nenin 11 par. të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65), i cili parasheh se “Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë për të cilën ai ose ajo nuk kanë qenë autor, redaktor ose botues dhe ai ose ajo nuk kishte dijeni, dhe nuk ekziston arsye të besohet, se ai ose ajo kontribuan në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes”, andaj duke pasur parasysh këtë dispozitë dhe në rastin konkret i padituri nuk ka qenë autor i parë i këtyre informatave por i njëjti vetëm i ka cituar të njëjtat atëherë edhe nuk konsiderohet si shpifje ose fyerje.

Me nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përcaktohet se: “Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë”.

Me nenin 10 paragraf 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktohet se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, gjykata gjeti se padituri nuk ka për detyrim që paditësve t’ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes së pretenduar, për shkak të informacionit shpifës së pretenduar ndaj personalitetit të paditësve, për arsye se në këtë rast rezultoi se

shkrimet në librin e publikuar nga i padituri ku ceken paditësit nuk përben shpifje dhe fyerje përpos një përshkrim i publikimeve të medimeve të ndryshme.

Gjithashtu gjykata i shqyrtoj edhe pretendimet tjera të paditësve mirëpo të njëjtit nuk kanë ofruar asnjë provë me anë të cilave do të vërtetohej se të njëjtit kanë demantuar informata e publikuara nga mediumet vendore dhe portalet e ndryshme ku në bazë të nenit 13 par 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65), i cili parasheh se “Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një gazetë, botim periodik, transmetim radioje ose televizioni, ose në çdo media tjetër të një natyrë periodike, për të cilin ose për cilat fakte janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korigjuar faktet që shqetësojnë atë person”, pra kanë pasur të drejtë ti kundërshtojnë dhe në rast se kanë kundërshtuar dhe është vërtetuar në ndonjë procedurë se informacionet e cekura në librin kontestues e që janë përshkruar nga mediumet dhe portalet e ndryshme janë vërtetuar si të pa sakta ose si shpifje, fyerje në raport me paditësit të njëjtit kanë qenë të obliguar që ato prova ti paraqesin në gjykatë sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitat e nenit 319.1 të LPK, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata nuk i mori për bazë deklarinimin e të paditurit se i njëjti këto informacione që i ka publikuar në librin i cili është objekt i këtij shqyrtimi kanë shërbyer për interes të përgjithshëm publik pasi që në neni 7 përcaktohen saktë se në cilat situata zbatohet kjo dispozitë dhe sqaron se kur një informatë konsiderohet në interes publik.

Në rastin konkret gjykata i shqyrtoj edhe provat tjera të cilat gjendeshin në shkresat e lendes mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje juridiko civile.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452, 463.1 të LPK-së, duke pasur parasysh faktin se asnjëri nga palët nuk i ka kërkuar të specifikuar shpenzimet procedurale, andaj vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:117655 - C.nr. 296/18, 14.12.2023

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, në Gjykatën

Numri i lëndës: 2019:117655
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05065993

e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.